

2505

124/1

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, bazuar në informacionin e përcjellë nga Instituti i Shëndetit Publik, ju bëjmë me dije se:

1. A ka kapacitete sistemi shëndetësor në vend për identifikimin dhe testimin e rasteve të dyshuara me virusin Mpox apo këto teste duhen referuar jashtë vendit?

Republika e Shqipërisë disponon të gjitha kapacitetet për të kryer testimin dhe diagnozën brenda vendit.

2. Në muajin maj 2022 Komiteti i Vaksinimeve ka rekomanduar vaksinën e lisë për kontaktet e afërta dhe grupet e rrezikut të virusit Mpox. A janë kryer vaksinime me këtë vaksinë në personel shëndetësor apo grupe rreziku prej vitit 2022 deri tani? Nëse po, sa vaksinime janë kryer?

Republika e Shqipërisë disponon vaksinë ndaj virusit Mpox, por deri tani nuk është përdorur asnjë dozë.

Duke ju falënderuar,

Eduart Dedej

Specialist

Spektori i Shërbimeve të Përgjithshme, Çështjeve Juridike dhe Emergjencave

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale